



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 428, datë 8.7.2021

P Ë R

**PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN
E RIKONSTRUKSIONIT TË OBJEKTEVE ARSIMORE, NË BASHKINË
KURBIN DHE CAKTIMIN E BASHKISË KURBIN SI NJËSI ZBATUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” e “iii”, 16, dhe 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr.137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 266 835 173 (dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e tetëqind e tridhjetë e pesë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë pa TVSH, për financimin e rikonstruksionit të objekteve arsimore në Bashkinë Kurbin, sipas detajimit të mëposhtëm:
 - a) Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare “Milot”, Bashkia Kurbin, në masën 147 116 112 (njëqind e dyzet e shtatë milionë e njëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e njëqind e dymbëdhjetë) lekë pa TVSH;
 - b) Rikonstruksioni i shkollës së mesme “Milot”, Bashkia Kurbin, në masën 119 719 061 (njëqind e nëntëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e gjashtëdhjetë e një) lekë pa TVSH.
2. Bashkisë Kurbin, për vitin 2021, i transferohet fondi në masën 53 367 034 (pesëdhjetë e tre milionë e treqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e tridhjetë e katër) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, nga hapësira buxhetore e siguruar pas ngurtësimit në të njëjtën masë të fondeve të

projekteve të rindërtimit me ecuri të ngadaltë, për rikonstrukcionin e objekteve arsimore, detajuar, si më poshtë vijon:

- a) Rikonstrukcioni i shkollës 9-vjeçare “Milot”, Bashkia Kurbin, në masën 29 423 222 (njëzet e nëntë milionë e katërqind e njëzet e tre mijë e dyqind e njëzet e dy) lekë pa TVSH;
 - b) Rikonstrukcioni i shkollës së mesme “Milot”, Bashkia Kurbin, në masën 23 943 812 (njëzet e tre milionë e nëntëqind e dyzet e tre mijë e tetëqind e dymbëdhjetë) lekë pa TVSH.
3. Caktimin e Bashkisë Kurbin si njësi zbatuese për rikonstrukcionin e objekteve arsimore, shkollës 9-vjeçare “Milot” dhe shkollës së mesme “Milot”, Bashkia Kurbin.
4. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kurbin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDESKRYEMINISTRI

ERION BRACE

**MINISTRI I SHTETIT
PËR RINDËRTIMIN**

ARBEN AHMETAJ